



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 2463/24 Datë: 03/12/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së tretë të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 26.11.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Aprovohet rekomandimi i Komisionit të ankesave sipas vendimeve Ref.:2184/24 dhe 2185/24 të datës 25.10.2024.
- II.** Korrigjohet vendimi i KShC-së Ref.:1765/24 i datës 28.08.2024, kompletohet arsyetimi sipas rekomandimit të Komisionit të ankesave, për programet:
 1. *Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 2. *Biomjeksi Laboratorike BSc 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 3. *Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- III.** Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Ref.:1765/24 i datës 28.08.2024, mbetet në fuqi dhe e pa ndryshuar.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

I. Paraqitje e shkurtër e kërkesës së palës;

Kolegji Universum kampusi kryesor pas pranimit të vendimit të KShC-së Ref.:1765/24 i datës 28.08.2024 i pa kënaqur me numrin e studentëve në programet e referuara në dispozitiv, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për ndryshimin e numrit të studentëve në programet:

4. *Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
5. *Biomjeksi Laboratorike BSc 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
6. *Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*

II. Shpjegimi i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

KShC në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 kishte nxjerrë vendimin Ref.:1765/24 i datës 28.08.2024 me të cilin ishin akredituar/riakredituar programet studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A)</i>	Flamur Hasimi Qendrim Maloku Nazife Hajdini Arjeta Gashi Fazli Redon Jashari
2.	<i>Biomjekësi Laboratorike BSc 180 ECTS (A)</i>	Dua Danjoli Shkelzen Elezaj Riaz Agahi Arianit Gashi
3.	<i>Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R),</i>	Marigona Dermaku Arianit Emra Rozafa Troni Albert Sylja

III. Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum kampusi kryesor me ekipet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit në përbërje: Antonio Pozo, Adrian Stan dhe Jadranka Pelikan.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) kishte hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit kishin dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Kozmetologji Bachelor Profesional 180 ECTS (A)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit. Prej nga dhe kanë rekomanduar që programi të akreditohet për periudhën tre (3) vjeçare me kuotën/numër maksimal 30 studentë për vit akademik. Për korrektësi në vendim do të bashkëngjisim edhe rekomandimin final në gjuhën angleze:
"In conclusion, the Expert Team considers that the study program Cosmetology, offered by Universum College is "substantially compliant" with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, recommends to accredit the study program for a duration of 3 years with a number of 30 students to be enrolled in the program."

2. **Për programin e studimit; *Biomjekësi Laboratorike BSc 180 ECTS (A)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 22.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit. Prej nga dhe kanë rekomanduar që programi të akreditohet për periudhën tre (3) vjeçare me kuotën/numër maksimal 30 studentë për vit akademik. Për korrektësi në vendim do të bashkëngjisim edhe rekomandimin final në gjuhën angleze:

"In conclusion, the Expert Team considers that the study program Laboratory Medicine, offered by Universum College is "substantially compliant" with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, recommends to accredit the study program for a duration of 3 years with a number of 30 students to be enrolled in the program."

3. **Për programin e studimit; *Higjiene Dentare Bachelor Profesional 180 ECTS (R)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit. Prej nga dhe kanë rekomanduar që programi të akreditohet për periudhën tre (3) vjeçare me kuotën/numër maksimal 40 studentë për vit akademik. Për korrektësi në vendim do të bashkëngjisim edhe rekomandimin final në gjuhën angleze:

"Overall, the Dental Hygiene study program at Universum College, despite its comprehensive design, falls short in execution, facing significant challenges that impede its ability to fully prepare larger number of students for successful careers as dental hygienists. In conclusion, the Expert Team considers that the study program Dental Hygiene, offered by Universum College is "substantially compliant" with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, recommends to accredit the study program for a duration of 3 years with a number of 40 students to be enrolled in the program."

IV. Baza ligjore e vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

KShC në zbatim të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë si dhe Manualit të akreditimit ka vendosur si në dispozitiv të vendimit.

V. Shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e tretë të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 26.11.2024, në vendimmarrjen e saj merr parasysh raportet e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të shpjeguara në detaje në paragrafin 3 të arsyetimit, ka rishqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum dhe rekomandimet e Komisionit të ankesave. Prandaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit KShC nuk mund të merr parasysh pretendimet e parashtruara në ankesë për ndryshimin e numrit të studentëve në programet respektive, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund ti drejtohet gjykatës kompetente afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Universum kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,